

Përtej Horizonteve: Udhëtim në Sri Lanka

.

Cmimet:

2750 Euro per person ne dhome teke

2299 Euro per person ne dhome dyshe/matrimoniale/treshe

Përshkrimi i shërbimit :

Dita e parë 09 Gusht

Nisja nga Tirana në orën 12.50

Dita e dytë 10 Gusht: Aeroport – Anuradhapura

(Rreth 4 orë udhëtim)

Mbërritja në Sri Lanka në orën 08.10, pritja nga partnerët tanë dhe transfertat për në Anuradhapura.

Anuradhapura është një qytet i madh në Provincën Qendrore Veriore dhe një atraksion turistik fantastik.

Një mbretëri shumë e rëndësishme në historinë e Sri Lankas, që tashmë është një vend trashëgimie botërore. Vendosur në tokat e thata të vendit, qyteti kishte nevojë për shumë rezervuarë uji për të mbështetur bujqësinë e tyre dhe për këtë arsye, Anuradhapura njihet për shpikjen e sistemeve më komplekse të ujitjeve në botën antike.

Udhëtimi në Sri Lanka përfshin vizitën në tetë vende të shenjta në këtë qytet, si dhe rrënoja nga e kaluara e lashtë, që përfshijnë pallate dhe manastire. Gjithashtu statuja dhe tempuj.

Akomodim në hotel dhe darka.

Dita e tretë 11 Gusht: Anuradhapura – Sigirya

Pas mëngjesit, do të nisemi për në Sigirya. (1 ore e 50 min me autobus).

Monumenti më i rëndësishëm i këtij qyteti është Tempulli i Shkëmbit të Artë në Dambulla. I njohur si Tempulli Rajamaha i Rangiri Dambulla, është një tempull i rëndësishëm për të gjithë ndjekësit e fesë Budiste. Tempulli, i cili ndodhet mbi një shkëmb konsiderohet si qendra e Sri Lankës.

I gdhendur në shkëmb, hapësira e tij përfshin 80 shpella, ku 5 të parat janë më të rëndësishmet të cilat mbajnë pasuri me vlera të mëdha historike dhe fetare.

Tempulli i Shkëmbit të Artë është një ndër tempujt më frymëzues dhe mahnitës në gjithë botën.

Kohë e lirë dhe më pas do të transferohemi në hotel në Sigirya.

Darka në hotel.

Dita e katërt 12 Gusht: Sigirya – Kandy

(3 ore me autobus)

Elite Travel Agency

Rr. Kozma Naska, Nr: 33/6, 3001 Elbasan, Albania.

Rr. Faik Konica, 1000 Tirana, Albania

Telephone: +355 69 204 4656, Email: elitetravelagency@etg.al

www.elitetravel.al

Pas mëngjesit do të vizitojmë Fortesën e Shkëmbit të Sigiriyas.

Sigiriya, që njëherë ishte një Mbretëri e famshme, është vërtet një atraksion i madhështor. Fortesa e Shkëmbit të Sigiriyas u ndërtua nga Mbreti Kasyapa, i cili ka një histori për tu mbajtur në mend.

I pakënaqur nga ajo cfarë i ofronte babai i tij, ai e vrau atë dhe u arratis në pyllin e Sigiriyas për tu fshehur. Zgjodhi një nga shkëmbinjtë e zonës për të ndërtuar fortesën e tij dhe për ta kthyer atë në pallatin më të mahnitshëm të kohës.

Pallati ka një hyrje në Portën e Luanit, ndërsa putrat e Luanit janë shkallët për tu ngjitur në majë të shkëmbit. Ambientet e pallatit përfshijnë kopshtet arkeologjike më të njohura me kopshte ujore, guva dhe tarraca. Atraksione të tjera brënda fortesës përfshijnë afreske, grafite dhe muret e pasqyrave.

Do të vazhdojmë me një vizitë në Kopshtet e Erëzave në Matale.

Kanella, Kardamon, Piper, Shafran , Vanilje e shumë lloje të tjera erëzash do ti ndjeni e shihni në këto kopshte dhe të njiheni me mënyrën e kultivimit dhe të përdorimit të tyre.

Ndalesa e fundit do te jetë në Kandy.

Kandy konsiderohet si qyteti Mbretëror i Sri Lankës për shumë arsye. Ky qytet mahnitës është i ndërtuar në një pllajë rrethuar nga kodra dhe male shkëmborë.

Në mbrëmje shijoni një mbrëmje kulturore me kërcime tradicionale dhe fishekzjarre.

Akomodim në hotel në Kandy dhe darka.

Dita e pestë 13 Gusht: Kandy – Ella – Yala

(5 ore e 30 min)

Pas mëngjesit do të nisemi për në Yala (Park kombëtar dhe rezervat natyror). Një ndalesë në Ella, ku mund të admirojmë bukurite natyrore të Sri Lankës.

Do të vizitojmë Urën me nëntë Harqe, e njohur ndryshe si “Ura në Qiell”, ndërtuar për të lidhur 2 male gjatë periudhës koloniale me një gjatësi 91 metra dhe lartësi 30 metra.

Më pas do të vizitojmë Ujëvarën “Ravana Ella” e cila ka një lartësi rreth 25 metra dhe është një nga pamjet natyrore më mahnitëse të Sri Lankës.

Mbërritja në Yala, akomodim në hotel dhe darka.

Dita e gjashtë 14 Gusht: Safari në Yala – Bentota

Pas mëngjesit do të kemi një ditë të mrekullueshme në parkun natyror të Yala. Do të vizitojmë parkun me Jeep Safari për të parë nga afër banorët e tij si Elefantë, Arinj, Leopardë , Buaj të egër, Krokodilë etj.

Pas drekës do të vazhdojmë në Galle, një qytet që konsiderohet si perla arkitekturore e Sri Lankës. Ky tur do të përfshijë vizitë në Fortesën e Galle, Farin, Kullën e Sahatit, Portin dhe Plazhin.

Do të vazhdojmë për në Bentota, akomodim në hotel dhe darka.

Dita e shtatë – tetë 15 – 16 Gusht: Bentota

Udhëtimi në Sri Lanka vazhdon me një vizitë në plazhin e mrekullueshëm. Do të shijojmë për 2 ditë plazhin relaksues të Bentota ku mund të qetësohemi në plazh, ose të marrim pjesë në aktivitetet që ofron ky vend si Jet Ski, Zhytje, gara me varka etj.

Dita e nëntë 17 gusht: Bentota – Colombo Aeroport
Pas drekës do të nisemi për në Colombo. Do të bëjmë një city tour të Kryeqytetit të Sri Lanka dhe do të shijojmë mbrëmjen në atmosferën e gjallë të këtij qyteti deri në 23.00 kur do të bëhet nisja për në aeroport.

Dita e dhjetë 18 Gusht
Fluturimi për në Tiranë 02.15 me tranzit në Dubai dhe mbërritje në Tiranë në orën 11:50

Detajet e Turit

Ju lutem shikoni më poshtë të gjitha detajet e Turit

Përfshihen në çmim

07 Netë fjetje në hotel sipas programit
Mëngjeset dhe darkat sipas programit
Transfertat nga/ne aeroport
Viza (85 USD)
Transporti me autobus komod me ajër të kondicionuar
Guidë vendase në anglisht gjatë gjithë turit
Shoqerues nga agjensia gjatë gjithë udhëtimit
Safari në Parkun Kombëtar të Yala
Biletat e hyrjeve sipas programit

NUK përfshihen në çmim

Drekat
Shpenzime personale
Ekskursionet shtesë
Bakshish për guidën dhe shoferin
Gjithçka që nuk përmendet në rubrikën “përfshihet”

Shumë e rëndësishme :

- Klienti duhet të paraqitet 3 orë përpara fluturimit në aeroport
- Pasaporta duhet të jetë e padëmtuar dhe brenda afatit të vlefshmërisë (6 muaj)

Fluturimi

Fluturimi Shqiperi – Sri Lanka 09 Gusht 2024

Nisja nga Tirana Airport (TIA) – Dubai Airport (DXB) – TIA

12.50 – DXB 20.10

Nisja nga Dubai Airport (DXB) -Bandaranaike Aiport (CMB) – DXB 01.55- CMB 08.10

Fluturimi Sri Lanka – Shqiperi 18 Gusht 2024

Nisja nga Bandaranaike Airport (CMB) – Dubai Airport (DXB) – CMB 02.15 – DXB 05.15

Nisja nga Dubai Airport (DXB)- Tirana Airport (TIA) – DXB 08.10- TIA 11.50

Politikat e Shërbimit

Rezervimi me Elite Travel Agency është i sigurt dhe i thjeshtë

PA KOSTO TË FSHEHURA

Shikoni çdo çmim të mundshëm pa tarifa rezervimi ose kosto të tjera të fshehura.

SIGURI NË TRANSAKSIONET TUAJA

Ne ndjekim standardet më të larta të protokolleve të sigurisë për t’i ofruar mysafirëve tanë siguri “online”.

POLITIKAT E PRIVATËSISË

Ne interesohemi për privatësinë e të dhënave tuaja personale dhe marrim të gjitha masat për t’u siguruar që jemi duke ecur me hapin e kohës përpara i përket rregullave për mbrojtjen e të dhënave.

SHËRBIMI NDAJ KLIENTIT

Rezervimi në faqen tonë është i shpejtë dhe i thjeshtë. Nëse keni kërkesa specifike, ekipi ynë i Operacioneve do të jetë gati për t’ju asistuar.

KONFIRMIMI I REZERVIMIT ME E-MAIL

Menjëherë pasi të keni kryer rezervimin, një e-mail me të gjitha detajet e rezervimit do të vijë në adresën tuaj.

PAGESA PER REZERVIMIN

Pagesa per rezervimin do te kryhet ne dy pjese: 50% e pageses do te kryhet ne momentin e rezervimit, 50% deri ne 21 dite para nisjes

Nëse dëshironi të ndryshoni specifikat e rezervimit tuaj, mund të na kontaktoni në një nga numrat e telefonit ose me e-mail.

POLITIKAT E KANCELIMEVE

Ne rast te anulimit nga klienti aplikohen penalitetet si me poshte :

40 % nese anulimi behet deri 30 dite perpara nisjes

75 % nese anulimi behet 30 deri ne 15 dite perpara nisjes

100% nese anulimi behet 14 dite perpara nisjes

Nese klienti qe kerkon te anulloje udhetimin e zevendeson rezervimin e tij me nje person tjeter, atehere politikat e anulimeve do te diksutohen sipas rastit konkret.

Anullimi do të quhet se është kryer në momentin që klienti paraqitet personalisht (ose i përfaqësuar nga një pjestar i grupit kur udhëtimi është rezervuar në grup) në njërin nga zyrat e agjencisë ose duke dërguar e-mail në adresën info@etg.al për t'u tërhequr nga marrëdhënia e krijuar me agjencinë.